



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

***Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre***

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/M14-24 Prot.

Tiranë 02/06/2023

Nr. Dok. 202100609/24

Lënda: *Rekomandim për trajtimin e rastit të shtetases M.M.*

**Drejtuar: AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE
pranë MINISTRISË SË MBROJTJES.**

TIRANË

Për dijeni: PREFEKTIT TE QARKUT KORÇË

KORÇË

Znj.M.M

Korçë

Të nderuar !

Sikurse jeni vënë në dijeni nga korrespondenca jonë zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë znj. M.M. Nëpërmjet kësaj ankese kjo shtetase shpreh shqetësimin e saj lidhur me zvarritjen e procedurave të akordimit të ndihmës shtetërore, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, pas dëmtimit të shkaktuar banesës së saj, si pasojë e rënies së zjarrit. Konkretisht në këtë ankesë parashtron ndër të tjera se: ".....Më datë 30.05.2009, ka rënë zjarr në banesën e saj, e cila ndodhet në lagjen Saraq, të fshatit Vithkuq, Komuna Vithkuq, Korçë. Për shkak të këtij zjarri banesa e saj ka pësuar dëme të konsiderueshme, si pasojë e të cilit shtëpisë së saj i kanë mbetur vetëm muret dhe çatia e shkapëputur. Në lidhje me këtë rast është mbajtur proces-verbali përkatës, nga Komisioni i Emergjencave të Komunës Vithkuq. Gjithashtu nga e Komisionit të ekspertëve

është bërë vlerësimi i dëmit i cili për anën ndëtimore ka rezultuar në masën 75290 lekë, ndërsa për dëmet në orendi dhe pajisje në masën 20.000 lekë. Me vendimin Nr 21 datë 22.06.2009, Këshilli i Komunës Vithkuq, për shkak se dëmi ka qenë i madh, ia ka kaluar për shqyrtim Këshillit të Qarkut Korçë, dhënien e ndihmës në lidhje me rastin. Ankuesja pretendon se edhe pse ka kaluar çdo afat ligjor, ajo nuk është dëmshpërblyer ende”, pavarësisht se është ankuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me këtë problematikë.

Gjendur para kësaj situate, ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje dhe zgjidhjen e këtij problemi, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të saj të ligjshme.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht nenet 13,17/a dhe 18/b, ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Qëndrimi i Këshillit të Qarkut Korçë, Prefektit Korçë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes, lidhur me rastin .

1. Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij*, si dhe në nenin 19/b të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, me tonën Nr. K3/M14-2 prot., datë 27.04.2021, kemi kërkuar pranë Këshillit të Qarkut Korçë, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit nëse qëndrojnë pretendimet e ankueses si dhe mundësinë e zgjidhjes së problematikave të saj.
2. Me shkresën Nr. K3/M14-5 prot., datë 06.05.2021, Këshilli i Qarkut Korçë, në përgjigje të shkresës sonë me Nr. K3/M14 - 2 prot, datë 27.04.2021, me objekt: *“kërkesë për shpjegime”*, lidhur me sa sipër, na ka informuar ndër të tjera se : *“Për rastin e rënies së zjarrit në banesën e znj. M.M, Institucioni i Këshillit të Qarkut ka kryer të gjitha procedurat ligjore në zbatim të VKM-së Nr 206, datë 26.03.1998, e cila ka qenë në fuqi në atë kohë. Këshilli i Qarkut në pamundësi financiare për të përballuar dëmin me shpenzimet e veta, ka përcjellë dokumentacionin përkatës në Prefekturën e Korçës, për zbatimin e procedurave ndjekëse ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave. Bashkëlidhur shkresës K3/M14/5, datë 06.05.2021, Këshilli i Qarkut Korçë, ka dërguar të gjithë aktet që disponojnë për rastin në fjalë si më poshtë vijon:*
 - shkresë *“Për dërgimin e dokumentacionit të emergjencës”* Nr prot. 913, datë 17.07.2009, Prefektit të Qarkut Korçë,

- Relacion “Mbi dëmtimin nga zjarri të banesës së ankuses në komunën Vithkuq, fshati Vithkuq, Qarku Korçë, datë 16.07.2009;
- Vendim Nr 21, datë 22.06.2009 , i Këshillit të Komunës Vithkuq;
- Proces-verbal datë 30.05.2009, i Komisionit të Emergjencave të Komunës Vithkuq;
- Vërtetim datë 22.06.2009, i Komunës Vithkuq;
- Çertifikatë familjare dhe personale datë 08.06.2009;
- Vërtetim “Për rënie zjarri”, datë 04.06.2009 i Sektorit të PMNZSH, Prefekti Qarkut Korçë.
- Preventiv i Komisionit të Ekspertëve dhe planimetria përkatëse.

3. Në rrethanat sa sipër cituar në vijim të hetimit administrativ të rastit me tonën Nr. K3/M14-6 prot., datë 25.05.2021, kemi kërkuar, pranë Prefektit të Qarkut Korçë të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë, pranë këtij institucioni, në lidhje me rastin që i përket ankuses M.M.

4. Me shkresën K3/M14 -7 prot., datë 04.06.2021, Prefekti i Qarkut Korçë, në përgjigje të shkresës sonë me Nr. K3/M14-6 prot., datë 25.05.2021, me objekt: “kërkesë për informacion”, lidhur me ankesën e shtetas M.M, ka shpjeguar ndër të tjera se : “Bazuar në legjislacionin për dëmshpërblimin financiar në rastet e fatkeqësive natyrore konkretisht VKM nr.206, datë 26.03.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish (aktualisht i shfuqizuar), dhe VKM Nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“ institucioni i Prefektit ka detyrim dërgimin e dokumentacionit të përgatitur nga Njësia Vendore (ish komunat, bashkitë dhe këshilli i qarkut), në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, aktualisht Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për rastet e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore. Për rastin e znj. Miho, Institucioni i Prefektit ka dërguar dokumentacionin pranë DPEC me shkresën Nr 727/1 prot., datë 23.07.2009. DPEC pas verifikimit të rregullsisë të dokumentacionit, me shkresën Nr 1087, datë 27.02.2015, e ka kthyer për plotësim të dokumentacionit dosjen e znj. Miho. Pas plotësimit të parregullsive nga njësia vendore përkatëse, me shkresën Nr 301/2 prot., datë 16.03.2015, dosja e znj M.M. është dërguar në DEPC pranë MPB. Në bazë të legjislacionit të sipërpërmendur, çelja e fondeve për dëmshpërblimin e familjeve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore, ose nga fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore bëhet nga DPEC. (sot AKMC pranë MM), për çdo njësi vendore. Për të marrë informacion të saktë mbi faktin nëse është akorduar fond për dëmshpërblimin e kësaj familje duhet t’i drejtoheni AKMC në MM .

5. Në këto kushte i jemi drejtuar me shkresën Nr. K3/M14-8 prot., datë 12.07.2021, me objekt: “kërkesë për informacion ”, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, së cilës i kemi kërkuar të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës zyrtar nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, lidhur me akordimin e fondeve për dëmshpërblim përsa i takon rastit në fjalë.

6. Me shkresën Nr K3/M14 -9 prot., datë 27.07.2021, *Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile*, ka shpjeguar ndër të tjera se: “*Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar VKM-së 206, datë 26.03.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, nuk disponon dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish komuna Vithkuq, për rastin e shtetases M.M.*”
7. Në kuadër të planit të hetimit me shkresën Nr. K3/M14-10 prot., datë 31.08.2021, me objekt: “*kërkesë për informacion*”, i jemi drejtuar sërish Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nëpërmjet së cilës i kemi bërë me dije se në rastin e znj. M.M, jemi gjendur në një situatë të paqartë dhe kontestuese në përgjigjet që japin dy institucionet . Konkretisht na ka rezultuar se :
 - a) *nga njëra anë nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, mbahet qëndrimi se nuk disponojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish komuna Vithkuq, për rastin e shtetases M.M.*
 - b) *ndërsa nga ana tjetër Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, në shpjegimet e dhëna Institucionit të Avokatit të Popullit, ka sqaruar se: “ Me shkresën Nr 727/1 prot., datë 23.07.2009, Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, e ka dërguar dokumentacionin pranë DPEC. DPEC pas verifikimit të rregullsisë së dokumentacionit, me shkresën Nr 1087 datë 27.02.2015, e ka kthyer për plotësim të dokumentacionit dosjen e znj. M.M. (shkresë e cila është përcjellë në rrugë zyrtare pranë institucionit tonë). Pas plotësimit të dokumentacionit nga Njësia Vendore përkatëse, me shkresën Nr 301/2 prot., datë 16.03.2015, dosja e znj. M.M, është dërguar në DPEC pranë MPB. (bashkëlidhur ju kemi dërguar shkresën sa sipër)”*.
8. Në rrethanat sa sipër në ndjekje të hetimit të plotë të rastit i kemi kërkuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të na dërgojë një informacion të saktë dhe të plotë zyrtar, nëse janë protokolluar dhe për pasojë edhe dorëzuar pranë këtij institucioni shkresat e sipërcituara, (me referencat përkatëse të protokollit të dërguara nga ana e Prefekturës së Qarkut Korçë), si dhe dokumentacionin shoqërues bashkëngjitur që ka të bëjë me rastin që i përket ankueses M.M.
9. Me shkresën Nr. K3/M14 -11prot., datë 16.09.2021, “kthim përgjigje”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka shpjeguar ndër të tjera se: “Bazuar VKM-së 206, datë 26.03.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish“, nuk disponon dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish komuna Vithkuq, për rastin e shtetases M.M. Dokumentacioni i dërguar nga organet e qeverisjes vendore në ish Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile bazuar kthimeve të dokumentacioneve në referencë të shkresave Nr 3513 prot., datë 09.06.2016, dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016 është kthyer, pasi nuk disponohej i saktë dhe i plotë, dhe nuk mund të administrohej nga ana jonë.” (Bashkëlidhur ka dërguar shkresat e sipërcituara për kthimin e dokumentacionit)”
10. Në vijim të kësaj korrespondence, për të qartësuar dhe për të hedhur dritë bazuar në dokumentacionin referues përkatës të rastit, i jemi drejtuar sërish Prefektit të Qarkut Korçë, me shkresën Nr. K3/M14-12 prot., datë 04.11.2021, me objekt: “*kërkesë për informacion*, të cilit i kemi kërkuar në mënyrë eksplicite sa më poshtë vijon:
 - *Të na informojë në lidhje në lidhje me hapat e ndërrmarë lidhur me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës, pranë këtij Institucioni*

nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016, dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme për rastin e ankueses M.M, në lidhje me dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e rënies së zjarrit në banesën e saj (bashkëlidhur kësaj shkresen kemi dërguar shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016, dhe Nr. 6623 prot., datë 07.11.2016)

- Çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje.

11. Prefekti i Qarkut Korçë na ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. K3/M14-13 prot., datë 15.11.2021”, në të cilën ka shpjeguar ndër të tjera se: “Bazuar në legjislacionin për dëmshpërblimin financiar për rastet e fatkeqësisë natyrore konkretisht VKM-së nr 206, datë 26.03.1998 ”Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish” (aktualisht i shfuqizuar) dhe VKM-së nr 329 datë 16.05.2012 ”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, institucioni i Prefektit ka detyrim dërgimin e dokumentacionit të përgatitur nga Njësia Vendore (ish Komunitat, bashkitë dhe Këshilli i Qarkut) në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (në Ministrinë e Punëve të Brendshme) aktualisht Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, pranë Ministrisë së Mbrojtjes), për rastet e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore. Për rastin e znj. M.M. Institucioni i Prefektit ka dërguar dokumentacionin pranë DEPC me shkresën Nr 727/1 prot., datë 23.07.2009. DPEC pas verifikimit të rregullsisë së dokumentacionit me shkresën Nr 1087 datë 27.02.2015, ka kthyer për plotësim të dokumentacionit dosjen e znj. M.M. Pas plotësimit të pasaktësive nga njësi vendore përkatëse me shkresën Nr 301/2 prot., datë 16.03.2015, dosja e znj. M.M. është dërguar në DPEC, pranë MPB”.

Në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj për hapat e ndërmara nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (aktualisht Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) të shkresave Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, ka sqaruar se në këto dy shkresa bashkëlidhur listat shoqëruese përkatëse të kthyer për shkak të pasaktësive të identifikuar nuk përfshihet emri i M.M. Bashkëlidhur ka paraqitur kopje të shkresave Nr. 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr. 6623 prot., datë 07.11.2016, së bashku me listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që ndodhen në Arkivin e Institucionit të Prefektit, lista të cilat nuk na ishin dërguar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në dokumentacionin e përcjellë pranë Institucionit tonë.

12. Në rrethanat kur sipas listave përkatëse shoqëruese bashkëlidhur shkresave sa sipër cituar për kthim dokumentacioni të dërguar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për Institucionin e Prefektit të Korçës, për shkak të pasaktësive të identifikuar me listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që ndodhen në Arkivin e Institucionit të Prefektit” rezulton se nuk përfshihet emri i M.M, për të cilat u vumë në dijeni në rrugë zyrtare nga dokumentacioni i plotë i kësaj praktike i përcjellë nga Prefekti i Qarkut të Korçës, i jemi ridrejtuar në mënyrë të

përsëritur *Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile*, me shkresën Nr. K3/M14 – 14 prot., datë 27.04.2021, në të cilën i kemi kërkuar sa më poshtë vijon:

- 12.1 Të na japë shpjegime si dhe një informacion sa më konkret, analitik dhe shterues si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me çështjen e parashtruar sa sipër, e në mënyrë specifike të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës, nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë, me shkresën Nr 301/2 prot, datë 16.03.2015, pranë DPEC, Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me dosjen që i përket ankueses M.M.
- 12.2. Veç sa sipër ju kemi bërë të ditur faktin se bashkëlidhur shkresave Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, nuk na janë dërguar prej këtij institucioni në mënyrë nominale listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që pretendoni se i keni dërguar Institucionit të Prefektit të Korçës, dhe për pasojë ju kemi kërkuar që të na i dërgoni, pasi ju i referoheni pikërisht këtij dokumentacioni kur na informoni se nuk keni dokumentacion, për rastin pasi e keni kthyer zyrtarisht atë.
13. Në përgjigje të Tonës me Nr. K3/M14 – 14 prot., datë 27.04.2021, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me shkresën Nr. K3/M14-15 prot., datë 13.12.2021, ka informuar ndër të tjera se: “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nën kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara, nga veprimtaria njerëzore dhe bazuar VKM-së 206 datë 26.03.1998 “Për kriteret dhe pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, nuk disponon dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish Komuna Vithkuq, për rastin e shtetasës M.M. Për sa më sipër, në trajtimin e rasteve për akordimin e ndihmës financiare dhe specifikisht për shtetasen në fjalë, duhet të disponohet dhe të përcillet i plotë dhe i saktë nga organet e qeverisjes vendore dokumentacioni tekniko-ligjor”
14. Ndërsa në përgjigje të shkresave tona Nr. K3/M14 – 16 prot., datë 12.01.2022, dhe Nr. K3/M14-18 prot., datë 09.02.2022, me shkresat Nr. K3/M14-17 prot., datë 02.02.2022, dhe Nr. K3/M14-19 datë 24.02.2022, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile na ka informuar ndër të tjera se: “Në përgjigje të shkresës suaj kërkesë e përsëritur për informacion” lidhur me kompesimin financiar mbi banesën e dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 30.05.2009, dhe informacion mbi dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar për shtetasen, banore në lagjen Saraq, Njësia Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë, ju bëjmë me dije se:
- 14.1 “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nën kuadrin e akordimit të ndihmës financiare për banesat e shtetasve të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe bazuar VKM-së 206, datë 26.03.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësie”, nuk disponon dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga ish Komuna Vithkuq, për rastin e shtetasës M.M.
- Përsa sipër trajtimi dhe administrimi i rastit për akordimin e vlerës financiare, nuk mund të realizohet si pasojë e mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar dhe përcjelle më tej nga njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
- 14.2 Meqenëse nuk kemi marrë përgjigje për secilën nga pyetjet që i kemi parashtruar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të cilat i kemi konsideruar të rëndësishme për hetimin

administrativ të rastit, me qëllim sqarimin sa më objektiv dhe konform ligjit të rastit, i jemi ridrejtuar në mënyrë të përsëritur, me shkresën Nr K3/M14-20 prot., që të na dërgojë një informacion sa më konkret, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të specifikuara sa më poshte:

1. *Në mënyrë specifike na informoni në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të ndjekura pas përcjelljes së dokumentacionit përkatës, nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë, me shkresën Nr 301/2 prot, datë 16.03.2015, pranë DPEC, Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me rastin që i përket ankueses M.M.*
 2. *Na dërgoni listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që i keni dërguar Institucionit të Prefektit të Korçës, konkretisht shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, së bashku me listat në të cilat sipas qëndrimit të mbajtur nga ana juaj rezultojnë të jetë edhe emri i ankueses emri i M.M, ose çdo lloj dokumentacioni tjetër i cili ka shërbyer për kthimin në mënyrë ndërinstytucionale nga ana juaj të dokumentacionit të kësaj shtetase për pasaktësi tek Prefektura e Qarkut Korçë ashtu siç keni shpjeguar me Tuajën Nr 1016/2 prot., datë 13.09.2021 (bashkëlidhur kësaj kësaj shkrese), si dhe na saktësoni në mënyrë të qartë kohën se kur është kthyer ky dokumentacion? .*
 3. *Na dërgoni dhe fletën e inventarit për këtë dosje ku keni pasqyruar edhe llojet e pasaktësive të identifikuara lidhur me rastin në fjalë, të cilën ia keni dërguar Prefekturës së Qarkut Korçë.*
 4. *Çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje.*
15. Në përgjigje të shkresës sonë, me shkresën Nr. K3/M14 – 21 prot., datë 08.04.2022, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile na ka informuar se : “Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara dhe me qëllim administrimin e rastit të sipërpërmendur, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me shkresën Nr 86/8 prot., datë 30.03.2022,”kërkesë për dërgim dokumentacioni tekniko-ligjor”, ka përgatitur shkresën për vënien në dispozicion të dokumentacionit tekniko-ligjor për rastin e shtetasës M.M. Lidhur me këtë shkresë kemi konstatuar se në përgjigjen tuaj, nuk kanë marrë përgjigje pyetjet e parashtruara nga ana jonë lidhur me trajtimin e rastit të znj. M.M, si dhe shkresës kthim përgjigje përcjellë pranë institucionit tonë, nuk i janë bashkëlidhur listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që ju i keni dërguar Institucionit të Prefektit të Korçës, konkretisht shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016.
16. Në vijim të kësaj korrespondence me shkresën Nr. K3/M14-23 prot., datë 21.11.2023, në përgjigje tonës Nr. K3/M14-23 prot., datë 07.11.2022 ,“kërkesë e përsëritur për informacion dhe dokumentacion”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka informuar se: “Bashkia Korçë në referencë të shkresës tonë nr.86/8 prot., datë 30.03.2022, kërkesë për dërgim dokumentacioni tekniko-ligjor”, ku kemi kërkuar dërgimin e dokumentacionit tekniko-ligjor me qëllim administrimin e rastit të shtetasës M.M, nëpërmjet shkresës nr 250/prot., datë 21.04.2022 “dërgim informacioni”, na informon se për çështjen në fjalë disponon vetëm shkresën Nr 484/1 prot., datë 02.06.2021 të Prefektit të Qarkut Korçë.

Për sa sipër në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga njësitë e qeverisjes vendore për rastin e shtetasës M.M, nuk mund të ndërmerren masa për përfitimin e kompesimit financiar të pretenduar”.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime:

17. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është një nga autoritetet e mbrojtjes civile, e cila si një institucion dhe strukturë qendrore ushtron përgjegjësinë e saj në drejtim të planifikimit të fondeve jo vetëm për marrjen e masave parandaluese, por edhe rehabilituese ndaj fatkeqësive.
18. Vlerësojmë se lidhur me rastin në fjalë, veprimtaria administrative e kryer prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nuk kanë qenë efikase dhe nuk i është përgjigjur situatës emergjente, si pasojë e së cilës ka rezultuar se deri më sot akoma nuk është zgjidhur kjo problematikë e ankueses M.M, për shkak të mosakordimit të fondit për ndihmë financiare, në favor të ankueses M.M.
- 18.1 Konkretisht ka rezultuar se pas rënies së zjarrit në banesën e shtetases M.M, më datë 30.05.2009, Komuna Vithkuq, ka ndjekur procedurën dhe ka hartuar dokumentacionin përkatës konform ligjit të kohës Nr 8756 datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile, pikës 3 të VKM-së Nr 206, datë 26.03.1998, (e cila ka qenë në fuqi në atë kohë). Më tej me vendimin Nr 21 datë 22.06.2009, Këshilli i Komunës Vithkuq, për shkak se dëmi ka qenë i madh, ia ka kaluar për shqyrtim Këshillit të Qarkut Korçë, dhënien e ndihmës në lidhje me rastin .Ku i fundit si ka kryer të gjitha procedurat ligjore në zbatim të VKM-së Nr 206, datë 26.03.1998, (e cila ka qenë në fuqi në atë kohë), në pamundësi financiare për të përballuar dëmin me shpenzimet e veta, ka përcjellë dokumentacionin përkatës në Prefekturën e Korçës, për zbatimin e procedurave ndjekëse ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave.
- 18.2 Intitucioni i Prefektit ka dërguar dokumentacionin pranë DEPC¹ me shkresën Nr 727/1 prot., datë 23.07.2009. Dosja ka mbetur pa veprime nga ana e këtij organi të cilit vetëm për të bërë verifikimin e rregullsisë ose jo të dokumentacionit të ankueses i është dashur rreth 6 vjet . Konkretisht pasi ka konstatuar pasaktësi lidhur me rastin e ka kthyer për plotësim të dokumentacionit dosjen e znj. M.M, me shkresën Nr 1087 datë 27.02.2015. Pas plotësimit të parregullsisë nga njësia vendore përkatëse, me shkresën Nr 301/2 prot., datë 16.03.2015, dosja e znj. M.M, është dërguar në DEPC pranë MPB, Që nga ajo kohë e deri më sot jo vetëm që nuk është mundësuar akordimi i fondeve për këtë shtetase, por nuk ka patur asnjë akt administrativ i cili do të përfundonte procedurën administrative lidhur zgjidhjen e rastit të ankueses, apo qoftë edhe shkresë “Për kthim dokumentacioni “ për pasaktësi të identifikuar në dokumentacionin që i përket ankueses.
19. Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ana juaj se dokumentacioni i dërguar nga organet e qeverisjes vendore në ish Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile është kthyer për shkak se nuk disponohej i saktë dhe i plotë, (dhe nuk mund të administrohej nga ana juaj) , me shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016, dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, evidentojmë faktin se edhe pse nga ana juaj është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme të na i dërgoni dokumentacionin e plotë për kthimin e praktikës, që ju referoni se dispononi dhe keni hartuar lidhur me rastin objekt hetimi administrativ, nga ana juaj nuk u paraqitën në asnjë rast, pavarësisht shkresave të përsëritura të bëra prej nesh.
- 19.1 Sqarojmë këtu se nga ana juaj ky dokumentacion nuk na është përcjellë i plotë pasi na keni sjellë vetëm shkresat e sipërcituara, por jo :
- a) listat përkatëse emërore
 - b) fletën e inventarit për secilën prej këtyre dosjeve e në mënyrë të veçantë për dosjen e ankueses

¹ (Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile), aktualisht Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

c) si dhe nuk na keni kthyer përgjigje që të na saktësoni në mënyrë të qartë kohën se kur është kthyer ky dokumentacion nga ana juaj për rastin e ankueses M.M. ?

20. Në këtë kontekst tërheqim vëmendjen se nga hetimi i thelluar administrativ e konkretisht bazuar në korrespondencat zyrtare me Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë ka rezultuar se: në këto dy shkresa të referuara sa sipër nga ana juaj konkretisht Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr 6623 prot., datë 07.11.2016, nuk përfshihet emri i shtetases M.M, fakt ky që rezulton nga listat shoqëruese bashkëlidhur shkresave sa sipër e të kthyer për shkak të pasaktësive të identifikuara. Bashkëlidhur ky institucion ka dërguar kopje të shkresave Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr. 6623 prot., datë 07.11.2016, me listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që ndodhen në Arkivin e Institucionit të Prefektit.
21. Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.
- 21.1 Bazuar në legjislacionin për dëmshpërblimin financiar për rastet e fatkeqësisë natyrore konkretisht ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” , dhe VKM 206, datë 26.03.1998 “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në rast fatkeqësish” (aktualisht të shfuqizuara) dhe VKM nr 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, vlerësojmë se Institucioni i Prefektit ka përmbushur detyrimin ligjor për dërgimin e dokumentacionit të përgatitur nga Njësia Vendore (ish Komunat, bashkitë dhe Këshilli i Qarkut) në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (në Ministrinë e Punëve të Brendshme) aktualisht Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes), për rastin në fjalë. Për rastin e znj. M.M, Institucioni i Prefektit ka dërguar dokumentacionin pranë DEPC me shkresën Nr 727/1 prot., datë 23.07.2009. DEPC pas verifikimit të rregullsisë së dokumentacionit me shkresën Nr 1087 datë 27.02.2015, ka kthyer për plotësim të dokumentacionit dosjen e znj. M.M. Pas plotësimit të pasaktësive nga njësia vendore përkatëse me shkresën Nr 301/2 prot., datë 16.03.2015, dosja e znj. M.M, është dërguar në DEPC, pranë MPB”.
- 21.2 Ndërsa vlerësojmë se në ushtrim të funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe në përmbushje të përgjegjësisë të parashikuara në ligj, gjatë veprimtarisë administrative të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me rastin rezulton mosveprim krejtësisht i pajustificuar nga ana juaj në ushtrimin e kompetencave detyruese ligjore, e për pasojë janë kryer veprime ose mosveprime që bien ndesh me frymën e parimeve të Kodit të Procedurës Administrative, e konkretisht konstatojmë se:
22. “Është cënuar parimi i ligjshmërisë i cili parashikohet në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca”.

- 22.1 Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë i cili parashikohet në nenin 13 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.
- 22.2 Parimi i objektivitetit, i cili sanksionohet në nenin 14 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: "Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative."
- 22.3 Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit, i cili parashikohet në nenin 18/2 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se : "Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se veprimtaria administrative e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nuk është zhvilluar në përputhje me parimet ligjore mbi bazë të të cilit është normuar veprimtaria e këtij organi. Ushtrimi i detyrave sikurse parashikuar në ligj, është i detyrueshëm në këtë situatë në të cilën ndodhet çështja e prezantuar, pasi Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile si një nga organet shtetërore të përcaktuara në ligj është përgjegjëse ndër të tjera edhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia si dhe duhet të bashkërendojë punën jo vetëm për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara por edhe për riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.
23. Evidentojmë faktin se gjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të cilat nuk kanë qenë në korelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre, ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm ² për të.
24. Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është me vend të sjellim në vëmendjen tuaj, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet shprehimisht se: "*Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi*".
25. Mosveprimi juaj në këtë kuptim, ju vendos në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike", i ndryshuar, pasi realisht ankueses i është shkaktuar një dëm pasuror, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje. Në kuptim të përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankuesit si person privat, në ushtrim e sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3/a, të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë: -Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme". Kujtojmë se, organet e administratës shtetërore janë të detyruara që qytetarëve tu sigurojnë, realizim të drejtë dhe efikas të të drejtave, lirive kushtetuese e ligjore,

² Neni 22/2 i Kodit të Procedurës Administrative.

si dhe interesave të tyre të ligjshme gjatë një procedure administrative. Të drejta dhe interesa këto të vërtetuara dhe të njohura me ligj. Në ushtrimin e veprimtarisë tuaj duhet të udhëhiqeni nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara. Kjo pasi çdo organ administrativ duhet ta mbështesë veprimtarinë e tij administrative tek parashikimet ligjore e nënligjore, si dhe të përgjigjet për veprimet e tij tek autoritete të tjerë administrativë, legjislativë ose juridikë. Përgjegjshmëri do të thotë gjithashtu që asnjë autoritet nuk duhet të përjashtohet nga hetimi, duke përfshirë hetim nga gjykatat, ankim tek një organ administrativ më i lartë, investigim nga Avokati i Popullit, inspektim nga një bord ose komision special dhe hetim nga një komision parlamentar. Përgjegjshmëria është një instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, të qenit i hapur, parimi i transparencës, parimi i paanësisë dhe barazisë para ligjit. Përgjegjshmëria është esenciale për të siguruar vlera si eficaenca, efektiviteti, besueshmëria dhe parashikueshmëria e administratës publike.

- 25.1 Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e bëra në nenet 5 dhe 8, të ligjit të lartpërmendur (Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999), ju si organ publik, duhet tashmë që të filloni një procedurë administrative për njohjen e dëmit që i keni shkaktuar znj. M.M, duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e dëmit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësiwe përkatëse.
26. Në vijim të analizës sonë, theksojmë se : Në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë faktin se gjatë komunikimit institucional me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit , në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial. Kështu në përgjigjet e dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është mjaftuar vetëm në përmendjen e akteve të mbajtura prej Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si dhe referencat gjenerike ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj organi. Por sqarojmë se nuk ka dhënë asnjë shpjegim të arsyetuar që të sqarojë se çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash konkrete ka ndërmarrë në përmbushje të detyrave të saj funksionale për të siguruar detyrimin e saj ligjor lidhur me zbatimin e ligjit në lidhje me rastin, Gjithashtu nuk i ka kthyer përgjigje në mënyrë të përsëritur, çështjeve të specifikuara për informacion nga ana Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
- 26.1 Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në më shumë se në një rast, çmojmë se ky qëndrim ka cënuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike.
- 26.2. Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Proedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3 i këtij ligji përcakton se: 1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficaencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e

administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.

- 26.3 Në këtë kontekst, sqarojmë se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.
- 26.4 Mungesa e informacionit dhe e dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel europian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikatori.
27. Në këtë këndvështrim, duam t’ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: “Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.
28. Referuar rastit në hetim , nuk rezulton që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile si një organ administrativ të ketë zbatuar detyrimet ligjore në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor.
- 28.1 Detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 i saj, i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentat e brendshëm të një shteti.
- 28.2 Në respekt të këtij parashikimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues, konkretisht:
- Neni 42: pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”.
- Neni 15, pika 2, i Kushtetutës parashikon se: “*Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”.
29. Në analizë të parashikimeve Kushtetuese rezulton se ankuesja, për shkaqe të pavarura nga ajo nuk ka marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, e për rrjedhojë ajo nuk e gëzon të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi. Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së shtetases M.M. kufizon liritë dhe të drejtat e saj të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

30. Një tjetër çështje që sjellim në vëmendjen Tuaj për shkak të zgjatjes së procedurës administrative është cënimi i parimit të sigurisë juridike.
- 30.1 Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Organet e administratës nuk mund të përkeqësojnë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojnë të drejtat e fituara ose të shpërfillin interesat legjitime të tyre.
- 30.2 Besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm jo vetëm për t'u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese por edhe nga veprimtaria e administratës gjatë veprimtarisë së saj, e cila duhet të garantojë ligjshmërinë e veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.
- 30.3 Shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund ti jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.
- 30.4 Organet e administratës publike duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ. Kjo procedurë, nuk është përfunduar në mënyrë të rregullt dhe nga një hetim i thelluar administrativ, nga ana e Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile pa asnjë shkak të justifikuar ligjorisht edhe pse është kërkuar vazhdimisht përfundimi i saj.
- 30.5 Sa sipër, ky institucion gjendet në shkelje të procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e procesit administrativ, në kushtet që edhe pse kanë kaluar disa vite akoma nuk është adresuar dhe trajtuar ë mënyrë përfundimtare rasti, edhe pse dokumentacioni përkatës ka qenë i përcjellë në rrugë zyrtare pranë këtij institucioni, evidentojmë faktin se nuk rezultoi e njëjta gjë për kthimin e këtij dokumentacioni në rrugë zyrtare për shkak të pasaktësive të konstatuara. E për pasojë jemi në kushtet nuk është mundur ende akordimi i ndihmës financiare për ankuesen M.M.
31. Sa sipër, bazuar në neni 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit ”* i ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkeljet të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për akordimin e ndihmës financiare për shtetasen M.M, banesa e së cilës është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore, konkretisht si pasojë e rënies së zjarrit në banesën e saj.
- Marrjen e masave lidhur me nxjerjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë çuar në cënimin e së drejtës së ankueses duke mos vijuar procedurën administrative të çeljes së fondeve

për dhënien e ndihmës financiare për shtetasen M.M, lidhur me dëmtimin që banesa e saj ka pësuar nga rënia e zjarrit.

- Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen, pra të mosveprimit të institucionit tuaj, duke mos respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.
- Shpërblimin e dëmit të shkaktuar ankuseses, sipas parashikimeve e vlerës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte.
- Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të praktikës së dokumentacionit të ankuseses :

- shkresë “Për dërgimin e dokumentacionit të emergjencës” Nr 913 prot., datë 17.07.2009, (1 fletë);
- Relacion “Mbi dëmtimin nga zjarri të banesës së ankuseses në komunën Vithkuq, fshati Vithkuq, Qarku Korçë, datë 16.07.2009; (1 fletë);
- Vendim Nr 21, datë 22.06.2009 , i Këshillit të Komunës Vithkuq, (1 fletë);
- Proces-verbal datë 30.05.2009, i Komisionit të Emergjencave të Komunës Vithkuq (1 fletë);
- Vërtetim datë 22.06.2009, i Komunës Vithkuq (1 fletë);
- Çertifikatë familjare dhe personale datë 08.06.2009; (2 copë);
- Vërtetim “Për rënie zjarri”, datë 04.06.2009;i Sektorit të PMNZSH, Prefekti Qarkut Korçë. (1 fletë);
- Preventiv i Komisionit të Ekspertëve dhe planimetria përkatëse; (3 fletë);
- shkresat Nr 3513 prot., datë 09.06.2016 dhe Nr. 6623 prot., datë 07.11.2016, bashkëlidhur listat e shtetasve me dokumentacion jo të rregullt që ndodhen në Arkivin e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë (4 fletë);

Në mungesë dhe me Urdhër

K O M I S I O N E R

AHMET PRENÇI

d.v